



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH. nr. 306/20**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Alfa I” SH.P.K.- Lipjan, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese” - , me nr. të prokurimit: 624-18-5071-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”, më datën: 12.06.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.HEDHET si e pa lejuar**, ankesa e operatorit ekonomik: “Alfa I” SH.P.K.- Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese”, me nr. të prokurimit: 624-18-5071-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”.

**II.VËRTETOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese”, me nr. të prokurimit: 624-18-5071-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë” .

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues, “Alfa I” SH.P.K.- Lipjan, hidhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Alfa I” SH.P.K.- Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.05.2020 me nr. 306/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese ”, me nr. të prokurimit: 624-18-5071-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë” .

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,7, 9,59, 62,108 A, si dhe nenin 44.5 të Rregullave dhe udhëzuesit operativ për Prokurim Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertet Shqyrtuese të prokurimit në raportin e dt: 01.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

### **PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Alfa I” SH.P.K.- Lipjan,**

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE shpjegon se me datë 27.04.2020 është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin “Komuna Suharekë me datë 10.04.2020 ka pranuar shkresë (e-mail) nga Sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës, ku na sqaron lidhur me projektin Ndërtim i impiantit të mbeturinave ricikluese në Suharekë, se Qeveria e Kosovës gjatë planifikimit të buxhetit me Qarkorën e dytë buxhetore këtë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore, dhe se ky projekt nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2020”.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke pas parasysh faktin se AK nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi që tregon arsyen e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, eksperti me dt. 29.05.2020, ka dërguar email AK-së, duke i kërkuar dëshmitë që AK është thirrur për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

AK me dt. 29.05.2020, ka kthyer përgjigje duke dërguar korrespondencën si me poshtë:



**From:**Avdullah Berisha  
**Sent:** Friday, April 10, 2020 9:35 AM  
**To:**Izedin Bytyqi  
**Cc:** Ismail Rudari; Bali Muharremaj ; Agim Bylykbashi  
**Subject:** RE: Kërkesë për informata shitesë.

Sqarime lidhur me Projektin: Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluake në Suharekë. MMPH në vitin 2018 kishte nënshkruar memorandum bashkëpunimi për këtë Projekt ne vlerë prej 3,500,000.00€ i tërë buxheti i ndarë për këtë projekt ka shkuar ne suficit buxhetor, edhe ne vitin 2019 kishim te ndarë buxhetin për këtë Projekt ne vlerë prej 1,514,759.00€ qe i tërë buxheti ka shkuar ne suficit buxhetor, andaj gjatë planifikimit buxhetit me Qarkoren e dytë buxhetore këtë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore ish ministri z. Matoshi. Por i nderuar z. Kryetar ju kishte paralajmëruar edhe krye shefi ekzekutiv z. Ilir Morina përmes postes elektronike me datën 15 Nëntor qe ky Projekt nuk do te jetë ne buxhetin e vitit 2020.

Lidhur me pretendimet e OE ankues se që deri më tani nuk kemi pranuar mbi refuzimin/aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e AK. Ndërsa AK-ja me datë 08.05.2020 e ka publikuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë kundërligjore, sepse ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe nuk na ka kthyer përgjigje, duke mos respektuar nenin 108/A të LPP-së dhe duke mos pezulluar aktivitetin e prokurimit deri ne shqyrtimin e ankesës sonë, por që ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit. AK-ja, nuk ju ka përmbajtur afatit ligjor për shqyrtim te ankesave maksimalisht 6 ditë, e që pastaj fillon të rrjedhë afati ligjor për parashtrimin e ankesës në OSHP 10 ditë.

Ekspertet shqyrtuese sqarojnë se në shkresat e lëndës të dorëzuar nga AK, shihet se AK ka bashkangjitur vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te OE ankues, vendim ky i dt. 15.05.2020.

Ekspertet shqyrtuese sqarojnë se ne pajtim me nenin 6 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, AK është i thirrur që menjëherë pas pranimi të një kërkesë për shqyrtim të bej pezullimin e aktiviteti te prokurimit, andaj ne rastet tjera AK duhet te ketë parasysh depozitën e lartcekur dhe e njëjta te respektohet nga AK.

Ekspertet shqyrtuese konstatojnë se duke pas parasysh faktin se çështja e përgjegjshmërisë se OE ankues OE "ALFA.I" SH.P.K, është vendosur me vendimin PSH nr. 915/19, PSH nr. 138, 162/20. vijmë në përfundim se çështja e përgjegjshmërisë se OE në fjale konsiderohet si çështje e gjykuar (res judicata), nga OSHP.

Mendimi i eksperteve shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertet shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues hedhet si e pa lejuar, vërtetohet vendimi i AK-së, Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Projektimi dhe Ndërtimi i impiantit të mbeturinave ricikluese” me nr. të prokurimit: 624-18-5071-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Suharekë.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e eksperteve shqyrtuese.

Operatori Ekonomik, me datë: 03.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e eksperteve Shqyrtuese.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

**Paneli shqyrtues** pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron ankesa është parashtuar kundër njoftimit për anulim.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE shpjegon se me datë 27.04.2020 është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin “Komuna Suharekë me datë 10.04.2020 ka pranuar shkresë (e-mail) nga Sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës, ku na sqaron lidhur me projektin “Ndërtim i impiantit të mbeturinave ricikluese në Suharekë, se Qeveria e Kosovës gjatë planifikimit të buxhetit me Qarkoren e dytë buxhetore këtë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore, dhe se ky projekt nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2020”.

Paneli shqyrtues sqaron se AK me dt. 29.05.2020, përmes email-it ka deklaruar se projekti në fjalë nuk është në planifikime buxhetore. Sipas tyre, MMPH në vitin 2018 kishte nënshkruar memorandum bashkëpunimi në vlerë prej 3,500,000.00€ i tërë buxheti i ndarë për këtë projekt ka shkuar në suficit buxhetor, edhe në vitin 2019 kishim të ndarë buxhetin për këtë Projekt në vlerë prej 1,514,759.00€ e që i



tërë buxheti ka shkuar ne suficit buxhetor, andaj gjatë planifikimit buxhetit me Qarkoren e dytë buxhetore ketë projekt e ka hequr nga linjat buxhetore ish ministri z. Matoshi. Sipas AK-së edhe krye shefi ekzekutiv z. Ilir Morina përmes postes elektronike me datën 15 Nëntor 2019, ka deklaruar qe ky Projekt nuk do te jetë ne buxhetin e vitit 2020.

Lidhur me pretendimet e OE ankues se që deri më tani nuk kemi pranuar mbi refuzimin/aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nga ana e AK. Ndërsa AK-ja me datë 08.05.2020 e ka publikuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë kundërligjore, sepse ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe nuk na ka kthyer përgjigje, duke mos respektuar nenin 108/A të LPP-së dhe duke mos pezulluar aktivitetin e prokurimit deri ne shqyrtimin e ankesës sonë, por që ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit. AK-ja, nuk ju ka përmbajtur afatit ligjor për shqyrtim te ankesave maksimalisht 6 ditë, e që pastaj fillon të rrjedhë afati ligjor për parashtrimin e ankesës në OSHP 10 ditë, paneli shqyrtues sqaron se në shkresat e lëndës të dorëzuar nga AK, shihet se AK ka bashkangjitur vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te OE ankues, vendim ky i dt. 15.05.2020, andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues sqaron se në pajtim me nenin 6 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, AK është i thirrur që menjëherë pas pranimit të një kërkesë për shqyrtim të bej pezullimin e aktiviteti te prokurimit, andaj ne rastet tjera AK duhet te ketë parasysh depozitën e lartcekur dhe e njëjta te respektohet nga AK.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertëve shqyrtues të rastit, duke pas parasysh faktin se çështja e përgjegjshmërisë se OE ankues OE "ALFA.I" SH.P.K, është vendosur me vendimin PSH nr. 915/19, PSH nr. 138, 162/20, vjen në përfundim se çështja e përgjegjshmërisë se OE në fjale konsiderohet si çështje e gjykuar (res judicata), nga OSHP.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron, se marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë, dhe ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar më parë dhe konsiderohet si çështje e gjykuar "res judicata", andaj duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe vendimin nga PSH .nr. PSH nr. 915/19, PSH nr. 138, 162/20, OE ankues, nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Suharekës, në pajtim të nenit 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, në të cilin thuhet:4 paragrafi 1 pika 26. Palë e interesuar -personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka

qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, andaj pretendimet e OE ankues, janë të gjykuara edhe më parë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
z. Blerim Dina



**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 /AK/ "KK Suharekë" ,

1x1 / OE/ "Alfa I" SH.P.K.- Lipjan,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.